



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. ~~88~~... Prot.

Tiranë, më 19.01.2026

URDHËR

Nr. 5, Datë 19/01/2026

**PËR MIRATIMIN E KALENDARIT PËR MATURËN SHTETËRORE DHE MATURËN
SHTETËRORE PROFESIONALE 2026**

Në mbështetje të Ligjit nr. 69, datë 21.06.2012, "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 78, datë 08.02.2006, "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta", i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", i ndryshuar, të Urdhrit të përbashkët të Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.661, datë 01.12.2023, "Për miratimin e Rregullores për zhvillimin e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar si dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Arsimit dhe Ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit nr. 27, datë 30.12.2025, "Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2026",


URDHËROJ

1. Miratimin e kalendarit për Maturën Shtetërore 2026, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Zyrtat Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe institucionet arsimore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Aida Myrto



Referenca	
Urdhri nr. 661, datë 01.12.2023, "Për miratimin e Rregullores për zhvillimin e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë"	
Periudha/Datat	
Kreu II	
Institucionet dhe strukturat përgjegjëse për zhvillimin e provimeve të maturës	
Neni 7, pika 15	Dërgon në QSHA, brenda datës 20 Prill 2026, listën e qendrave për provimet e Maturës Shtetërore.
Neni 8, shkronja "m"	Plotëson brenda datës 27 Prill 2026, bazën e të dhënave për maturantët/kandidatët për të gjitha vitet e shkollës së mesme, me përjashtim të vitit të fundit. Secilit maturant/kandidat i jepet një kopje e printuar e rezultateve të hedhura, të firmosura nga maturanti/kandidati, të vulosura dhe të firmosur nga drejtori i shkollës dhe kopja tjetër ruhet në arkivin e shkollës.
Neni 8, shkronja "n"	Plotëson në periudhën 1 – 12 Qershor 2026, bazën e të dhënave për maturantët/kandidatët për vitin e fundit të shkollës së mesme.
Neni 8, shkronja "p"	Në periudhën 15– 19 Qershor 2026 përfundon procesin e verifikimit dhe konfirmimit të rezultateve në sistem.
Kreu IV	
Aplikimi për provimet e maturës	
Neni 13, pika 2	Maturanti/kandidati bën aplikimin online, fillimisht në Portalin Qeveritar e-albania dhe më pas në sistemin "e-Matura", në periudhën 2 Shkurt – 11 Shkurt 2026. Aplikimi në sistemin "e-Matura", bëhet edhe sipas afateve të vendosura nga QSHA.